



KOMUNA KLINE
ZYRA E PROKURIMIT
01/351-34522/24
17.10.2024

Bazuar ne nenin 81 te Ligjit e Prokurimit Publik nr. 04/L-042 te hyre ne fuqi 01.12.2011, mbi Aktivitetet e Menagjimit te kontrates, Menagjeri i Zyres se prokurimit , bie kete

V E N D I M

Qe per Menagjimin e kontratës bazë nr. 93-2024 e datës 17.10.2024 Me titull “**Ndërtimi i rrugës tranzit në Klinë nga N 9-deri në R-104 Klinë- Gurokoc Lot -3 Më O.E ,, Gurëbardhi” sh.p.k. & G-Project & Asfalti sh.p.k. Rr: Abedin Rexha, Klinë** Me nr: Te prokurimit: **634-24-8802-5-1-1/C807** si dhe Nr: i biznesit **811243211** vlere e kontratës: **1.154.823.27 €**; per menagjim te kontrates do te jete: VISAR I. BOCI si bartes i aktiviteve , dhe implementues i projektit: Nga D.e. Urbanizmit **Enver Berisha** Afati i kontratës 36 muaj

Menagjeri i projektit ,njeherit edhe pergjegjes per menagjimin e kontrates , do te formoj komisionin per percjellje dhe komisionin per pranim.

Kryesyesi i aktivitetit te kontrates do te informoj ne gjithesecilen faze te aktiviteve zyren e prokurimit , dhe pas perfundimit te kontrates sjelle ne Zyre te prokurimit raportin detal mbi aktivitetin e menagjimit te kontrates.

Vendimi do te i dorzohet menagjerit te projektit sebashku me kontrate , oferten financiare.

Vendimit i bashkangjiten : kontrata , paramasa , plani dinamik , plani i mengjanimit te kontrates .

ZKA - KRYETARI

z. ZENUN ELEZAJ





KOMUNA KLINE
ZYRA E PROKURIMIT
01/351-34522/24
17.10.2024

Bazuar ne nenin 81 te Ligjit e Prokurimit Publik nr. 04/L-042 te hyre ne fuqi 01.12.2011, mbi Aktivitetet e Menagjimit te kontrates, Menagjeri i Zyres se prokurimit , bie kete

V E N D I M

Qe per Menagjimin e kontratës bazë nr. 93-2024 e datës 17.10.2024
Me titull “Ndërtimi i rrugës tranzit në Klinë nga N 9-deri në R-104 Klinë- Gurokoc Lot -3 Më O.E ., Gurëbardhi” sh.p.k. & G-Project & Asfalti sh.p.k. Rr: Abedin Rexha, Klinë Me nr: Te prokurimit: 634-24-8802-5-1-1/C807 si dhe Nr: i biznesit 811243211 vlera e kontratës: 1.154.823.27 €; per menagjim te kontrates do te jete: VISAR I. BOJAJ si bartes i aktiviteveve , dhe implementues i projektit:
Nga D.e. Urbanizmit **Enver Berisha** Afati i kontratës 36 muaj

Menagjeri i projektit ,njeherit edhe pergjegjes per menagjimin e kontrates , do te formoj komisionin per percjellje dhe komisionin per pranim.

Kryesyesi i aktivitetit te kontrates do te informoj ne gjithesecilen faze te aktiviteveve zyren e prokurimit , dhe pas perfundimit te kontrates sjelle ne Zyre te prokurimit raportin detal mbi aktivitetin e menagjimit te kontrates.

Vendimi do te i dorzohet menagjerit te projektit sebashku me kontrate , oferten financiare.

Vendimit i bashkangjiten : kontrata , paramasa , plani dinamik , plani i mengjanimit te kontrates .

ZKA - KRYETARI

z. ZENUN ELEZAJ



KOMUNA KLINË

Zyra e prokurimit

01 Nr 351-34664/29

DATE 17.10.2024

KONTRATË NR. 93-2024

Numri i kontratës:¹ 634-24-8802-5-1-1/C807

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik GURËBARDHI SH.P.K.; G-PROJECT; Asfalti SH.P.K., Abedin Rexha, KLINË, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Ndërtimi i rrugës tranzit në Klinë (nga N9- deri në R-104 Klinë- Gurakoc) me numër identifikues: 634-24-8802-5-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: Ndërtimi i rrugës tranzit në Klinë (nga N9- deri në R-104 Klinë- Gurakoc). Projekti është tre vjeçar ndërsa mjetet buxhetore janë të ndara për vitin 2024 – 500.000.00 ndërsa për vitin 2025, 2026 dhe 2027 janë të ndara pjesa tjetër

No.	Lot
3	Ndërtimi i rrugës tranzit në Klinë (nga N9- deri në R-104 Klinë- Gurakoc)Lot-3

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 1,154,823.27 €; Një milion e njëqind e pesëdhjetë e katërmijë e tetëqind e njëzet e tre Euro e njëzet e shtate Cent.

2.2 Plani dinamik është 36 muaj

2.3 sigurimi i ekzekutimit do të jete 115.482.30 Euro me validitet 36 muaj+ 1 muaj= 37 muaj

2.4 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Ne baze te situacioneve mbi kryerje te punimeve me Raport nga Organi Mbikëqyrës dhe Fature

- Mbajtja e parasë ne vlere 115.482.30 € do te paguhet pas Afatit te garancionit te punimeve mbas 12 muajve pas pranimit te përkohshëm teknik . Kjo mund te paguhet me garancion nëse ekzistojnë mjetet ne dispozicion)

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

Sigurimi i ekzekutimit

Plani dinamik

Menaxheri i kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetohet", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

[Ne rast të kontratave me vlerë të madhe]

Emri:	Pr.Dr. Zenun Elezaj	Emri:	Labinot Morina
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ	Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	17.10.2024	Data:	17.10.2024
Vula:		Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	HASAN GASHI
Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	
Data:	17.10.2024
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

**Ndertimi I rrugës tranzit (nga N9-deri në R-104 Klinë-Gurakoc). - Klinë
LOT_3**

**PARAMASA ME PARALLOGARI
Rruga dhe Një rrethrotullim
L=1157.88 m**

Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total
				€	€
1 INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN					
1.1	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në rrugë.	m'	1,157.88	1.00	1,157.88
1.2	Vendosja e dhe sigurimi i pikave të reja poligonale për percjellje të punëve gjeodezike në terren.	m'	1,157.88	1.00	1,157.88
1.3	Shenimi i trasesë si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit, si dhe përpilimi i projektit të ekzekutuar.	m'	1,157.88	2.00	2,315.76
1.4	Harimi i projektit të ekzekutuar, nëse gjatë impelmentimit të projektit ka pasur ndryshim/plotësim të trasesë apo koordinatave dhe kuotave ose ndonjë ndryshim/plotësim tjetër me aprovim nga Menaxheri i Kontratës të paraqitet në projektin e ekzekutuar së bashku me gjendjen e realizuar.	m'	1,157.88	5.00	5,789.40

Gjithsej 1: 10,420.92

2 PASTRIMI I TERENIT

2.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishtës për punë si dhe largimi i të gjitha llojeve instalimeve në punishtë në rast se ka në ato hapësira.	m'	1,157.88	1.00	1,157.88
2.2	Demontimi i rrethojave nga teli me gjemba, rrethojave metalike, rrethojave metalike me cokell betoni si dhe rrethojave prej mureve në të dyja anët e trupit të rrugës me largim dhe bartje deri në deponi max 15km, demontimi i reklamave dhe shenjave komunikuese dhe rivendosja e tyre aty ku ka mundësi, demolimi i leshesave gypore të dimensioneve të ndryshme. Të gjitha pozicionet e lartcekura përfshinë tërë trasesë e rrugës.	m'	50.00	3.00	150.00
2.3	Prerja e drunjeve dhe shkurreve (me nxjerrje të cungave dhe rrenjeve në dy anët e trupit të rrugës): Ø10-Ø50cm, me bartje në deponi në largësi min. 10 km.	m'	250.00	1.00	250.00

2.5	Dislokimin e shtyllave ekzistuese te drurit te fensionit te ulte dhe zevendesimin e tyre me shtylla dhe montimi i serisem i kablove ekzistuese ajrore dhe nentokesore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshem komplet me ateste per nje shtylle te dislokuar.	copë	3.00	500.00	1.500.00
-----	--	------	------	--------	----------

Gjithsej 2: 3,057.88

3 PUNËT TOKËSORE

3.1	Gërmimi i dheut i kategorisë së III- V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi max. 10km	m ³	30.811.38	3.50	107.839.83
3.2	Gërmimi i Humusit me t=20 cm me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi max. 10km, si dhe përdorimi për humusim të skarpateve.	m ³	5.184.43	3.50	18.145.51
3.3	Humusimi i skarpateve të rrugëve dhe rrethrotullimeve në mbushje me t=15 cm me shtrirje dhe formësim të materialit	m ³	1.811.15	3.00	5.433.45
3.4	Formësimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës me ngjeshmëri 30MN/m ²	m ²	15.821.38	1.00	15.821.38
3.5	Humusimi i sipërfaqeve të rrethrotullimeve me t=15 cm me shtrirje dhe formësim të materialit	m ²	644.00	2.00	1.288.00
3.6	Punimi i mbushjes me material rrethor për sipërfaqen e mbrendshme të rrethrotullimit	m ³	386.00	5.50	2.123.00

Gjithsej 3: 150,651.17

4 OBJEKTET

Lëshesat gypore, rigollat dhe muret BA

4.1	Gërmimi i dheut i kategorisë IV-VI-të për lëshesa gypore me ngarkim dhe bartje në deponi në largësi 2 km	m ³	126.00	3.50	441.00
4.2	Punimi i mbushjes me material të nxjerrur nga gërmimi i rrugës (40MN/m ²)	m ³	85.00	6.50	552.50
4.3	Furnizimi dhe vendosja e betonit C30/37 për rigola me trashësi t=15cm dhe gjeresi 75 cm sipas detajit të dhënë.	m'	666.00	20.00	13.320.00
4.4	Furnizimi dhe vendosja e skajprëve 18/24 për punimin e rigolave kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kriteret tjerë ngrirje shkrije-krypëra, abrazion	m'	666.00	20.00	13.320.00
4.5	Punimi i lëshesëve gypore me : Furnizimi, bartja dhe montim të gypave të armuar nga betoni të vendosura në shtresë tamponi me punim të bredhit, kokave të lëshesave ose parapeteve me C-25/30 dhe kalldermes me gure të vendosur në shtresë prej rere me mbushje të fugave me llaq cimentoje. Lëshesat Gypore Ø600 janë paraparë para hyrjeve të shtepive si dhe kyqjeve tjera				
	Ø600	m'	10.00	100.00	1.000.00
	Ø1000	m'	32.00	120.00	3.840.00

Gjithsej 4:

32,473.50

5 KONSTRUKSIONI I TRASËS SË RRUGËS

5.1	Furnizimi me material dhe punimi i mbushjes me material me CBR>15% me ngjeshje në shtresë me Msh=50 MN/m ²	m ³	45,143.24	6.50	293,431.06
5.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i materialit stabilizues (60MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-150mm me trashësi t=60cm, përfshihen edhe rrethrotullimet.	m ³	6,701.51	10.00	67,015.10
5.3	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i rrjetave nga materiali prej polietileni Gjeogridit MacGrid EG për stabilizimin e dherave dhe frases së rrugës.	m ²	11,600.00	3.00	34,800.00
5.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (80MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=25cm, përfshihen edhe rrethrotullimet.	m ³	2,941.70	15.00	44,125.50
5.5	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (100MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=15 cm.	m ³	1,433.69	15.00	21,505.35
5.6	Furnizimi dhe punimi i shtresës së asfaltbetonit AB 0-16, t=5cm.	m ²	8,105.16	5.00	40,525.80
5.7	Furnizimi dhe punimi i shtresës së Bitozhavorrit BZH 0-22, t=8cm	m ²	8,105.16	9.00	72,946.44
5.8	Furnizimi dhe sperkatje e shtresës së bitozhavorrit me emulzion, 0.4l/m ² .	m ²	8,105.16	0.35	2,836.81
5.9	Vendosja e skajorëve 18/24 në bazë betoni C12/15 kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kritereti tjerë ngrije shkrije-krypëra, abrazion. Klasa e betonit - C30/37	m'	100.00	15.00	1,500.00
5.10	Vendosja e skajorëve 10/20 kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kritereti tjerë ngrije shkrije-krypëra, abrazion. Klasa e betonit - C30/37	m'	65.00	13.00	845.00
5.11	Vendosja e kubezave të betonit me trashësi t=8cm, të pjesa e mbrendhme e rrethrotullimeve, kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kritereti tjerë ngrije shkrije-krypëra, abrazion. Në këtë pozicion të përfshihen shtresat e tamponit 0.4mm, t=5cm. Forma e tyre përzgjedhet nga investitori. Klasa e betonit - C25/30.	m ²	92.00	15.00	1,380.00
5.12	Punimi i bankinave me material guror jokoherent nga materiali i sjellur nga huaza në frasë.	m ³	722.83	3.00	2,168.49
5.13	Furnizimi dhe punimi i pahive elastike njëfishe me shtylla mbajtëse çdo 2 meter.	m ³	645.00	30.00	19,350.00
RRUGET LIDHESE					
5.14	Gërmimi i dheut i kategorisë IV-VI-të për themele të mureve dhe për-lëshesa gypore me ngarkim dhe bartje në deponi në largësi 2 km	m ³	56.00	3.50	196.00

5.15	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (80MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=15cm.	m ³	32.00	15.00	480.00
5.16	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (100MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=10 cm.	m ³	18.00	15.00	270.00
5.17	Furnizimi dhe punimi i shtreses së Bitozhavorrit BZH 0-22, t=8cm	m ²	150.00	13.00	1,950.00
Gjithsej 5:					605,325.55
6	LESHA PLLAKORE 2.5x2.5X33.0				
<p>Në çmime njësi duhet të llogariten te gjitha punët në lidhje me përgaditjen e kallëpeve, montimin dhe përforcimin e tyre si dhe skelet e nevojshme për kryerjen e operimeve të cilat ndërlidhen jo vetëm me punët e kallëpimit po edhe të betonimit të elementeve strukturore relative dhe punët tjera të ngjajshme. Klasa e betonit caktohet sipas rezultateve të llogarise statike. Te gjitha testet dhe shqyrtimet e nevojshme te përfshihen ne cmim.</p>					
6.1	Betoni I varfer t=10 cm nen pllaken e themelit. Klasa e betonit C16/20 <i>Llogaria në m³</i>	m ³	12.5	55	687.50
6.2	Betonimi i pllakes se themelit sipas llogarise statike . klasa e betonit C 30/37. Te përfshihet edhe punimi i pahive te zakonshme. <i>Llogaria në m³</i>	m ³	40	150	6,000.00
6.3	Betonimi i pllakes masive beton arme-saletonit sipas llogarise statike. klasa e betonit C 30/37. Te përfshihet edhe punimi i pahive te zakonshme. <i>Llogaria në m³</i>	m ³	19	150	2,850.00
6.4	Betonimi i mureve dhe kraheve te lesheses pllakore nga bet.arm. C30/37 sipas llogarise statike. Te përfshihet edhe punimi i pahive te zakonshme. <i>Llogaria në m³</i>	m ³	65	150	9,750.00
6.5	Betonimi i trajeve ne pllaken e themelit te lesheses pllakore nga bet.arm. C30/37 sipas llogarise statike. Te përfshihet edhe punimi i pahive te zakonshme. <i>Llogaria në m³</i>	m ³	16	150	2,400.00
6.6	Çeliku për armaturë do të aplikohet në përputhje të plotë me normat ENV 10080 si dhe të posedon me karakteristikat që vijojnë: Vlera karakteristike e kufirit të rrjedhjes (yield strength characteristic value) fyk=500 N/mm ² Madhësitë e diametrit të përputhen me vlerat nominale sipas ENV 10080 Furnizimi, prerja, lakimi dhe montimi i shufrave të armaturave duhet të bëhet sipas formave të paraqitura në detalet teknike si dhe të verifikohen në vendpunishte . Klasa e duktilitetit (ductility class) B-e lartë (high ductility) B 500 B. <i>Llogaria në kg.</i>	kg	13500	1.3	17,550.00
6.7	Germimi i dheut kategoria III dhe IV	m ³	250	3	750.00
6.8	Shtruarja e tamponit nen themele	m ³	50	15	750.00

6.9	Mbushja me material rrethor te granular CBR>5%	m ³	30	5.5	165.00
				Gjithsej 6:	40,902.50
7	NEN KALIMI KM4 +550.00				
Nr.	POZICIONI	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi Total (€)
7.1	Punet pergatitore				
7.1.1	Matjet dhe pikeimi i struktures	komplet	1	350	350.00
7.1.2	Pastrimi dhe pergatitja e terrenit si dhe hapja e rugeve ndihmese per punimin e urës (B=5.5m , tampon o-63mm , t=25cm , L=80m.	komplet	1	1500	1,500.00
				TOTALI 7.1:	1,850.00
7.2	Punet e dheut				
7.2.1	Germimi i dheut kategoria III dhe IV	m ³	250	3.5	875.00
7.2.2	Shtuarja e tamponit nen themele	m ³	200	15	3,000.00
7.2.3	Mbushja me material rrethor te granular CBR>5%	m ³	89	5.5	489.50
7.2.4	Gypat per drenazhim Ø 200	m	50	10	500.00
7.2.5	Material gur i thyer per drenazhim	m ³	10	15	150.00
7.2.6	Shtresa e argjiles se ngjeshur nen gypin drenazhues	m ³	15	15	225
				TOTALI 7.2:	5,239.50
7.3	Punet e betonit				
7.3.1	Furnizimi dhe vendosja ne veper e betonit te varfer C-16/20 nen tabanin e themeleve dhe nen pllaken kapercyese	m ³	25	55	1,375.00
7.3.2	Furnizimi dhe vendosja ne veper e betonit C-30/37 per themele	m ³	230	150	34,500.00
7.3.3	Furnizimi dhe vendosja ne veper e betonit per pllaken e ures- soletonin C-30/37 perfshihen edhe pahite	m ³	80	150	12,000.00
7.3.4	Betonimi i mureve dhe kraheve te lesheses pllakore nga bet arm. C30/37 sipas llogarise statike	m ³	285	150	42,750.00
				TOTALI 7.3:	90,625.00
7.4	Punet e armimit				
7.4.1	Furnizimi, prerja, lakimi dhe vendosja e armatures S-8500 per te gjitha pozicionet e ures	kg	38000	1.3	49,400.00
				TOTALI 7.4:	49,400.00
7.5	Asfalti				
7.5.1	Asfalti si shtresë mbrojtëse e hidroizolimit në soletën e urës, t=4 cm	m ²	220	8	1,760.00
7.5.2	Shtesa qarkulluese asfaltbeton, t=6cm.	m ²	220	10	2,200.00
				TOTALI 7.5:	3,960.00
7.6	Pajisjet				
7.6.1	Parmak mbrojtës për automjete (pahi elastike e njëfisht)	m'	20	25	500.00
7.6.2	Parmaku mbrojtës për këmbësor	m'	20	60	1,200.00
7.6.3	Guri skajor 18/24cm C30/37 M100	m'	20	15	300.00
7.6.4	Mbeshtetesat NEOPREN ELASTOMERIK me dimensione si ne llogari statike	cope	5	20	100.00
7.6.5	Fugat e dilatimit	m'	20	5	100.00
7.6.6	Ujëmbledhësit	copë	4	40	160.00
7.6.7	Gypat per largimin e ujit nga ura Ø 100	m'	20	10	200.00

7.6.8	Gypat per largimin e ujit nga ura Ø 200 me fiksues cdo 2.0m	m'	20	20	400.00
TOTALI 7.6:					2,960.00
Gjithsej 7:					154,034.50
8 Ujësjetësi					
	Furnizimi, Transporti dhe Montimi i Gypave HDPE 100 RC me saldime ballor.				-
8.1	HDPE 100, RC TIP2(10/75), Ø160 /PN20 bar	m'	1.157.88	25	28.947.00
8.2	Transporti i furnizimit dhe vendosja e shiritit zbulues me shirit alumini 20 cm mbi tubacionin e ujësjetësit (sipas kushteve në specifikimet teknike P.5.14.8).	m'	1.157.88	0.2	231.58
8.3	Gërmim llogore, kategoria e III-te, IV, V - VI me makineri, gjerësi dhe thellesi min. H = 1.2m sipas normave dhe standardeve. Sasia e llogaritur në qiendie të naieshur.	m³	927	3	2.781.00
8.4	Planifikimi i pjesës së poshtme të kanalit me saktësi deri në ± 1 cm.	m'	1.157.88	1	1.157.88
8.5	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorrit në fund të kanalit dhe në anën e tubit dhe ngjeshja në shtresa deri në 20 cm kuotë toke.	m³	140	15	2.100.00
8.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rërës 0-31.5mm t = 10cm për të mbuluar shtresën e fundit të kanalit dhe ngjeshja e rehabilitimit të rrugës.	m³	58	15	870.00
8.7	Mbushja e kanalit dhe planifikimi me nivel terreni me material të gërmuar me parë në vendet ku ka toka bujqësore, ndërsa në vendet urbane mbushja të bëhet me material mbushës CBR>15%. Sasia e llogaritur në qiendie të naieshur.	m³	730	10	7.300.00
8.8	Ngarkimi dhe transporti i dheut të gërmuar në vendin ku organi mbikëqyrës ka caktuar me laqresi nga L = 5km	m³	198	3	594.00
8.9	Ndërtimi i pusetave të gatshme të degëzimit sipas planeve ekzekutive me përmasa sipas projekti . Dimensionet dhe gjeometria e gropave për t'u përshtatur instalimit të pjesëve lidhëse. Llogaritur mbi çmimin e të gjitha punimeve të nevojshme si (Gërmim, izolim, Kallep, betonim i kapakut metalik me aftësi mbajtëse 40 ton dhe të gjitha punimet e kërkuara sipas kushteve teknike) dhe pjesës së dhënë. Llogaria e pusetes cdo 50 m' të shtrirjes së gypit të ujësjetësit	copë	23	350	8.050.00
TOTALI 8:					52,031.46

REKAPITULLIMI

1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN	10,420.92
2	PASTRIMI I TERENIT	3,057.88

3	PUNËT TOKËSORE	150,651.17
4	OBJEKTET	32,473.50
5	KONSTRUKSIONI I TRASËS SË RRUGËS	605,325.55
6	LESHA PLLAKORE 2.5x2.5X33.0	40,902.50
7	NEN KALIMI KM4 +550.00	154,034.50
8	UJËSJELLËSI	52,031.46
TOTALI		1,048,897.47

II KANALIZIMI ATMOSFERIK					
Vërejtje: Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vurjen në vepër të materialeve për secilin pozicion					
Nr.	Përshkrimi i punëve dhe materialeve	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi-€	Çmimi Total-€
2.1	Punët përgaditore				
2.1.1	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rrjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kaloj rrjeti i kanalizimit fekal si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik	m'	1560.00	1.00	1,560.00
2.1.2	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet më procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e detektimit me aparatura elektronike për instalime nëntokësore si dhe evidentimi i saktë i instalimeve që duhet të mirëmbahen gjatë kohës së ndërtimit dhe në rast demtimi të bëhet riparimi i tyre (rrjeti elektrik, rrjeti i telefonisë shtëpiake, etj)	m'	1560.00	1.00	1,560.00
Subtotali 1:					3,120.00
2.2	Punët Demoluese				
2.2.1	Demolimi i gypave të Kanalizimit dhe ujësjellesit ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin të cilin e cakton Organi Mbikqyrës.	m'	1560.00	1.00	1,560.00
2.2.2	Demolimi i pusetave prej betoni dhe materialeve tjera si dhe ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin të cilin e cakton Organi Mbikqyrës.	m'	1560.00	1.00	1,560.00
Subtotali 2.2:					3,120.00
2.3	Punët tokësore				

2.3.1	Gërmimi i kanalit për kolektorët kryesor dhe kolektorët e grilave në kat. III-IV të dheut, më makinë në gjërësi sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) dhe thellësi sipas profilit gjatësor. Në këtë pozicion përfshihet edhe largimi i dheut të germuar dhe transporti deri në largësi 10 km, largimi i ujrave me pompim, si dhe transporti deri në largësi 10 km.	m ³	3450.00	3.50	12,075.00
2.3.2	Sigurimi i kanalit nga shembja e dheut. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, sipas detalit në projekt, në të dy anët e kanalit. Sigurimi bëhet për thellësit dhe kategorinë e tokës që janë të parapara më masat e mbrojtjes në punë. Sasitë janë indikative dhe punëkryesi në bashkpunim me organin mbikqyrës vendos se ku do të aplikohen këto masa. Rrjedhimisht të dy mbajnë përgjegjësinë për këtë proces	m'	1560.00	2.00	3,120.00
2.3.3	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm.	m'	1560.00	1.00	1,560.00
2.3.4	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rërës 0-16mm në fundin e kanalit anash dhe mbi gypa	m ³	450.00	18.00	8,100.00
2.3.5	Mbulimi dhe planifikimi i kanalit me materail mbushës CBR 15 % dhe ngjeshja në shtresa 25cm deri në trupin e rruges. Mbulimi deri në shtresën e nënbazës së trupit të rruges	m ³	3,000.00	3.50	10,500.00
Subtotali 2.3:					35,355.00
2.4	Punët montuese				
	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN4 për kolektorët kryesor dhe sekondar				
	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 sipas standardeve.				
2.4.1	PESN8 Ø 315 mm	m'	1,560.00	20.00	31,200.00
2.4.2	PESN8 Ø 200 mm	m'	160.00	10.00	1,600.00
Subtotali 2.4:					32,800.00
2.5	Punët e betonit dhe armaturës				
2.5.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta me betonarme C-20/25 d=20cm	m ³	11.52	80.00	921.60
2.5.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për kineta më përpunim sipas detalit.	m ³	6.24	80.00	499.20
2.5.3	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø1000/1000mm (elemente të parafabrikuara).	m'	85.00	60.00	5,100.00
2.5.4	Furnizimi transporti dhe montim i konuseve për puseta prej betonit Ø1000/700/600mm (elemente të parafabrikuara).	copë	40.00	70.00	2,800.00
2.5.5	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave prej betonit të armuar Ø500/1000mm për pusetat e ujëmbledhëseve (elemente të parafabrikuara).	copë	40.00	70.00	2,800.00
2.5.6	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø20 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorrozive.	copë	280.00	5.00	1,400.00

2.5.7	Furnizimi, transporti, montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize, më aftesi mbajtëse 40t. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20/25.	copë	40.00	35.00	1,400.00
2.5.8	Furnizimi, transporti dhe montimi i grilave të pusetave për ujëbledhësat njëfishit (prej gize), Në çmim të llogaritet betoni i kurorës sipas detalit të dhëne prej beton armesë C-20/25.	copë	40.00	50.00	2,000.00
Subtotali 2.5:					16,920.80
2.6	Punët tjera				
2.6.1	Testimi i rrjetës së kanalizimit	m'	1560.00	1.00	1,560.00
Subtotali 2.6:					1,560.00

Rekapitulimi kanalizimi atmosferik					
2.1	Punët përgaditore				3,120.00 €
2.2	Punët demoluese				3,120.00 €
2.3	Punët tokësore				35,355.00 €
2.4	Punët montuese				32,800.00 €
2.5	Punët e betonit dhe armaturës				16,920.80 €
2.6	Punët tjera				1,560.00 €
Shuma e subtotaleve:					92,875.80 €

Projekti i Sinjalizimit LOT 3 = 1158 m'					
Vërejtje: Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vurjen në veçor të materialeve për secilin pozicion, duhet cekur se një numër i konsiderueshëm i shenjave vertikale vendosën 2 copa në një shtyllë.					
Nr.	POZICIONET	Njësia	Sasia	Çmimi / Njësi €	Çmimi Total €
3 SINJALIZIMI					
3.1	SINJALIZIMI HORIZONTAL (Termoplastikë, 3mm)				
3.1.1	Furnizimi dhe realizimi i vijës ndarëse të shiritave të qarkullimit (b= 15 cm) tipi A1 (1+1+1 m.), komplet gjatësia e kësaj vije.	m'	100	1.5	150.00
3.1.2	Furnizimi dhe realizimi i vijës së ndërprerë në udhëkryqe (b= 15 cm) tipi A (3+3+3 m.), komplet gjatësia e kësaj vije.	m'	1080	1.5	1,620.00
3.1.3	Furnizimi dhe realizimi i vijës plotë të shiritave të qarkullimit (b= 15 cm), e vetme	m'	50	1.5	75.00
3.1.4	Furnizimi dhe realizimi i vijës së kombinuar (b= 15 cm), kombinimi vija e plotë bashk me të ndërprerën 3+3+3	m'	30	2.5	75.00
3.1.5	Furnizimi dhe realizimi i vijës plotë anësore të skaj të shiritave të qarkullimit (b= 15 cm), (kufizimi i ishullit të mesëm dhe ndarja e shiritit të skajshëm)	m'	2300	1.50	3,450.00
3.1.6	Furnizimi dhe realizimi shenjave tjera (fushat e drejtimit, vendkalimi i kembesoreve, vija e ndalimit etj.)	m ²	35.00	20.0	700.00
3.1.7	Furnizimi dhe realizimi i shigjetave L = 5 m.	copë	14.00	100.0	1,400.00
TOTALI 3.1:					7,470.00
3.2 SINJALIZIMI VERTIKAL					
3.2.1	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) së shenjave të rrezikut (forma trekëndësh) me dimensionim a=90 cm.	copë	4	80.0	320.00

3.2.2	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) së shenjave të urdhëresa të prera (forma rrethore) me dimensionim Ø=60 cm.	cope	22	80.0	1,760.00
3.2.3	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) së shenjave të lajmërimit	cope	14	80.0	1,120.00
3.2.4	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) së shenjave të udhëkryqeve shkallët e lajmërimit me dimensionim sipas standardeve	m ²	12.00	120.0	1,440.00
TOTALI 3.2:					4,640.00
3.3 PAJISJET E KOMUNIKACIONIT					
3.3.1	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) së shenjave të "udhërrëfyese" me dimensionim sipas standardeve shiko kodet (VII-08, VII-13, VII-15)	copë	6	80.0	480.00
3.3.2	Pajisjet për shënimin e skajeve të rrugës (VII-01), me lartësi 0.75 m. mbi sipërfaqe dhe distancë prej 50 m.	copë	46	10.0	460.00
TOTALI 3.3:					940.00
Gjithsejt:					13,050.00

REKAPITULLIMI I PERGJITHSHËM		
I	PROJEKTI I RRUGËS	1,048,897.47 €
II	KANALIZMI ATMOSFERIK	92,875.80 €
III	SINJALIZIMI	13,050.00 €
TOTALI		1,154,823.27 €



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 634-24-8802-5-1-1/C807

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontaktuar.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë të Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmar punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim iu propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e diçenë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërbllimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

